

SISTEMI I MATJES, RAPORTIMIT DHE VERIFIKIMIT TË NDRYSHIMEVE KLIMATIKE NË SHQIPËRI: SHKARKIMET DHE ZBUTJA

Konteksti

Si palë e Marrëveshjes së Parisit dhe kandidate për anëtarësim në BE, Shqipëria duhet të raportojë të dhënat dhe veprimet për ndryshimet klimatike. Për këtë qëllim, duhet të krijohet dhe zbatohet një sistem kombëtar për matjen, raportimin dhe verifikimin (MRV) e të dhënave të ndryshimeve klimatike. Kjo nuk është arritur ende.

Ky projekt për gatishmërinë dhe mbështetjen përgatitore do të ndihmojë në krijimin e një sistemi kombëtar MRV për (i) shkarkimet e gazrave serrë (GS) dhe (ii) veprimet zbutëse. Ky sistem është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së të dhënave kombëtare të ndryshimeve klimatike dhe informacionit mbi vendimmarrjen. IKU do të asistojë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) në përcaktimin e metodave kombëtare MRV të shkarkimeve të GS-ve, si edhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ministritë e linjës, INSTAT-in, sektorin privat dhe njësitë e qeverisjes vendore me krijimin e strukturave administrative, procedurave dhe proceseve për sigurimin e të dhënave për AKM.

Krijimi dhe zbatimi i sistemit MRV do të mbështesë përmirësimin e cilësisë së raportimit kombëtar për ndryshimet klimatike, si dhe mobilizimin e financimit të klimës nga donatorët ndërkombëtarë.

Objektivat e Projektit

Objektivat e këtij projekti janë:

- Ofrimi i asistencës ndaj Qeverisë së Shqipërisë për përgatitjen e bazës nënligjore kombëtare për ngritjen e sistemit MRV të shkarkimeve të GS dhe veprimeve zbutëse;
- Zhvillimi i kapaciteteve teknike të Qeverisë së Shqipërisë dhe institucioneve shtetërore;
- Identifikimi, mbledhja dhe riorganizimi i bazave ekzistuese kombëtare të të dhënave mbi ndryshimet klimatike.

Produktet

- Bazë kombëtare të dhënash për shkarkimet e GS-ve dhe veprimet zbutëse;
- Përzgjedhja e treguesve të ndarë sipas gjinisë;
- Ngritja e kapaciteteve për AKM dhe aktorët përkatës;
- Module të mësimi elektronik të programit të ngritjes së kapaciteteve;
- Raport mbi stimujt e mundshëm financiarë për operatorët e sektorit privat;
- Raport i vlerësimit të fizibilitetit të zbatimit të metodës së vlerësimit dhe verifikimit të shkarkimeve të GS-ve me bazë atmosferike, me rekomandime;
- Raporti i themelimit dhe zbatimit të MRV-së, me rekomandime;
- Analiza e kosto-efektivitetit të zbatimit të sistemit MRV;
- Rekomandime politikash për përmirësim afatgjatë dhe afatmesme.

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

DONATORI:

Green Climate Fund (GCF)

PARTNERËT:

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
- Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU)

KOHËZGJATJA:

01/10/2022 - 01/10/2024

KONTAKT:

Zana Vokopola

Drejtor Ekzekutiv
Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd. 14 Hyrja 11,
Ap. 56 Tiranë, Shqipëri

M: +355694333808

E : zvokopola@uri.org.al

Breth IKU-t

Që nga viti 1999, Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë fokusohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë në qeveri, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim qasjen e publikut në informacion dhe lidhim partnerët e zhvillimit. URI ka punuar me donatorë si USAID, Swiss Cooperation, Ambasada Hollandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Fondacioni Shoqëria e Hapur, etj.

